

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare, Driton Muharremi dhe Have Haliti, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Eroll Gashi, si procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit E.B. nga fsh. ..., K. Prizren, për shkak të veprës penale Vrasjes së rëndë nga neni 147 pika 3 të KPRK-së dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, PKR.nr.69/15 datë 05.10.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 01.03.2018 mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, PKR.nr.69/15 datë 05.10.2017, **vërtetohet.**

## A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjakovë me aktgjykimin PKR.nr.69/15 datë 05.10.2017, të akuzuarin E.B. e ka liruar nga akuza konform nenit 390 par.1 pika.3 KPPK-se, për shkak të veprës penale Vrasjes së rëndë nga neni 147 pika 3 të KPRK-së dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së. Shpenzimet e procedurës, mbesin në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur:

- Prokuroria Themelore në Gjakovë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, duke propozuar që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën dhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore ta prish si të kundërligjshëm dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Prokurori i Apelit, me parashtrësën me shkrim PPA./I.nr.42/18 datë 24.01.2018, ka propozuar që ankesa e Prokurorit Themelor në Gjakovë të aprovoj si e bazuar, aktgjykimi të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e kësaj lënde, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore konstatoi:

-ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjakovë nuk është e bazuar.

Prokuroria në ankesë thekson se aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë ka të meta për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet, dispozitivi i aktgjykimit në pjesën liruese është në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës. Ky aktgjykim përmban edhe shkelje të tjera të rënda nga neni 386 par.2 dhe 3 të KPRK-së, këto të meta e bëjnë të parakohshëm, kundërligjorë dhe të paargumentuar. Aktgjykimin e vet gjykata e mbështet në dispozitën e nenit 390 par.1 pika 3 të KPRK-së, me faktin se gjykata nuk ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit E.B. qëndrojnë elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar. Prokuroria konsideron se gabimisht gjykata e shkallës së parë aplikoi dispozitën e nenit 390 par.1 pika 3 të KPRK-së duke konsideruar se nuk ka prova për përgjegjësinë penale të akuzuarit. Gjykata në mënyrë të gabuar gjithashtu ka vlerësuar deklaratat e dëshmitarëve të dëgjuar gjatë shqyrtimit gjyqësorë siç janë M.Q.1, M.Q.2, R.Q., R.H., N.T. dhe U.T.. Fakti se i ndjeri U.Q. është vrarë nga E.B. rezulton nga ekspertiza e balistikës e ekspertit L.R. dhe se në vendin e ngjarjes janë gjetur 15 gëzhjoja të kalibrit 9 x 19 mm, se i ndjeri U.Q. është vrarë nga plumbat e lartcekur e vërteton Ekspertiz e bërë nga eksperti mjeko ligjorë Doc. Dr. T.G. i cili është bazuar në procesverbalin e obduksionit ku deklaroi se plumbat e nxjerr nga trupi i të ndjerit janë të kalibrit 9 x 19 mm. Nga kjo ekspertizë rezulton në mënyrë gjeneralë se të gjitha plagët një nga një e kanë ndihmuar – përshpejtuar shkaku e vdekjes. Nga kjo rezulton se gjendja faktike u vërtetua në mënyrë jo të plotë dhe të gabuar, ngase gjykata nuk ia falë besimin provave të cilat u propozuan me akuzën publike, por i fali besimin mbrojtjes së të pandehurit E.. Me vërtetimin jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike gjykata gabimisht aplikoi të drejtën materiale. Këto rrethana e bëjnë aktgjykimin kontestues, të paqëndrueshëm dhe kundërligjorë.

Gjykata e Apelit e Kosovës me vëmendje e ka shqyrtuar ankesën e Prokurorisë themelore në Gjakovë dhe shkresat e lëndës dhe vlerësoi se ankesa është e pa bazuar. Aktgjykimi është i qartë dhe konkret, gjykata ka dhënë arsyet për faktet vendimtare, ka arsyetuar provat dhe në rastin konkret drejtë ka vepruar kur ka konsideruar se nuk ka prova të cilat e mbështesin dyshimin e bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprat penale të cilat i janë vënë në barrë në bazë të aktakuzës së Prokurorisë. Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike duke analizuar dhe arsyetuar të gjitha provat materiale dhe jo materiale, duke i ndërlidhur njëra me tjetrën dhe duke ardhë deri tek një gjendje faktike ku nuk vërtetohet fajësia e të akuzuarit. Gjykata e shkallës së parë ka administruar provat jo materiale si dëshminë e dëshmitarit R.H., M.Q.2, N.T., R.Q., M.Q.1., E.B.-T., S.R.T., EE.B. U.T., L.R., ka dëgjuar ekspertin e balistikës H.K., ekspertin Dr. T.G., zyrtarin policor M.B., nga provat materiale ka administruar raportin e laboratorit të kriminalistikës të SHPK në Prishtinë lidhur me 15 gëzhjotat e gjetura në vendin e ngjarjes dhe 7 plumbave të pa shkrepur si dhe një fisheku të therur me numër 2006-2265 të dt. 22.11.2006, është lexuar raporti mbi rezultatin e ekzaminimit grafologjik të laboratorit qendror të Forenzikës Ivan Vuçetiç të Republikës së Kroacisë e datës 26.04.2007, shikimi në tri letra ku dy janë të shënuara me lapls ngjyrë të kuqe dhe një letër me ngjyrë të kaltër të evidentuara si prova E #1, shiqimi në katër fletë të shkruar nga i akuzuari E.B. e evidentuar si prova E#2, shikimi në foto dokumentacionin në vendin e ngjarjes si dhe është lexuar procesverbali i obduksionit nga Instituti i Mjekësisë Ligjore me numër 108 të dt. 12.05.2000 për të ndjerin U.Q.. Nga këto prova gjykata e shkallës së parë vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të aktgjykimit të sajë duke dhënë një arsyetim për të cilën edhe kjo gjykatë e mbështetë dhe atë se nga këto prova u vërtetua se i ndjeri para luftës së

Kosovës ka marr letra kërcënuese nga persona të panjohur ku është kërcënuar se është bashkëpunëtor i Serbisë, se ka qenë polic rezervë dhe se për këtë do të paguaj ashtu që është detyruar të largohet nga Kosova për të punuar në Gjermani ndërsa pas luftës është kthyer në Kosovë dhe përsëri ka pranuar letra kërcënuese me përmbajtje të njëjtë. Natën kritike me datë 09.05.2000 pas mesnate i njëjti ka qenë në shtëpinë e tij së bashku me anëtarët e familjes duke fjetur në katin e dytë të shtëpisë së bashku me bashkëshorten ndërsa në dhoma tjera kanë fjetur anëtarët e tjerë të familjes, ashtu që një person i armatosur me armë zjarri, i maskuar me çorapë të zeza në kokë, korpulent dhe i zhvilluar ka hyr në dhomën e fjetjes të ndjeri U. dhe ka shtënë disa herë në të duke e qëlluar me plumba në pjesë të ndryshme të trupit ku i njëjti vdes në vend ndërsa personi i panjohur largohet. Ndërsa familjarët pas dëgjimit të shtënave kanë dalur nga dhoma mirëpo personi ishte larguar dhe asnjëri nga ata nuk ka mundur ta identifikoj, kanë ftuar fqinjët dhe e kanë lajmëruar policinë. Gjykata ka lexuar me pëlqimin e palëve deklaratën e bashkëshortes së të ndjerit U. e ku e njëjta ka deklaruar se personi i maskuar ka qenë i gjatë dhe i zhvilluar ndërsa ka deklaruar se personi – i akuzuari E. në atë kohë ka qenë i moshës 19 vjeçare ndërsa nga shiqimi i pamjes së tij shihet se i njëjti është i gjatësisë mesatare dhe i dobët dhe nuk përkon me përshkrimin e personit të asaj nate kritike. Ka deklaruar se natën kur i kanë lënë parat në vendin e caktuar ajo së bashku me djemtë e saj kanë qenë në shtëpinë e të akuzuarit dhe se atë natë ai ka fjetur me djalin e saj V. dhe i njëjti nuk është larguar nga dhoma. Nga dëshmia e dëshmitares M.B.3-vajza e të ndjerit shihet se ka deklaruar se natën kritike kur i është vrarë baba, i akuzuari E.B. që është kunati i sajë atë natë ka qenë në shtëpi, ka fjetur në kuzhinë, gjatë ditës ka punuar me babin e tij ndërsa atë natë e njëjta vajzën e ka pasur të sëmurë me temperaturë dhe gjatë gjithë natës ka qenë e zgjuar dhe E. i nuk ka dalur nga kuzhina dhe se herët në mëngjes rreth orës 07:00 së bashku me prindin ka shkuar në punë ndërsa ajo më vonë nga familjarët është njoftuar se i është vrarë i ati. Gjykata me të drejtë nuk ja ka falur besimin dëshmisë së dëshmitarit N.T. e i cili ka deklarua se nga babai i tije U. është njoftua se vëllai i gruas E. i ka qenë në shtëpinë e tij të pa banuar dhe e ka marrë armën e që e ka par babai i tij, deklaratë kjo që është mohuar nga babai i tije dëshmitari U. si dhe është mohuar edhe nga bashkëshortja e tije E. që përndryshe është motra e të akuzuarit, e po ashtu drejtë ka vendosur gjykata kur nuk ja ka falur besimin këtij dëshmitari pasi i njëjti humbjen e armës e ka paraqitur pas 5 viteve dhe atë pasi është paraburgosur për shkak të kidnapimit të mikut të tije me qëllim që të i kthehet bashkëshortja në shtëpi dhe pasi ka ra në burg e ka paraqit rastin. Meqë Prokuroria ka hequr pikën 7 të privimit të jetës së personit tjetër me qëllim të dobisë pasurore gjykata me të drejtë nuk është lëshuar në vlerësimin e ekspertizës grafologjike që ka pas të bëjë me letrat kërcënuese si dhe letra e cila është gjetur pas marrjes së 13.000 DM. Sa i përket ekspertizës balistike gjykata në rigjykim ka ftuar ekspertin e balistikës H.K. dhe L.R. e që pas dëgjimit të tyre eksperti H.K. ka dhënë sqarime rreth karikatorit të gjetur në shtëpinë e të akuzuarit dhe sqarimit rreth ekspertizës të dhënë në Gjykatën e Qarkut në Prizren duke theksuar se karikatorit i takon pushkës automatike të prodhimit gjerman, pas lufte i prodhuar edhe në ish Jugosllavi, i markës “Skorpion” i kalibrit 9x19 mm dhe jo i armës Tomson siç ka deklaruar në Gjykatën e Qarkut në Prizren e i cili është i kalibrit 10.35 mm ndërsa karikatorit që është parë në seancën e shqyrtimit gjyqësor është i kalibrit 9x19mm që i pranon prej 25 deri në 32 fishek dhe se fisheku që është gjetur në shtëpinë e të akuzuarit i pa shkrepur me 15 gëzhoja që janë gjetur në vendin e ngjarjes janë të njëjtit kalibër, 9x19 mm. Se është e pa kontestueshme se është bastisur shtëpia e të akuzuarit mirëpo në shkresat e lëndës mungon foto dokumentacioni si dhe procesverbali i kësaj bastisjeje ndërsa ekziston urdhëresa e lëshuar nga prokurori i shtetit por nuk ka konfirmim të kësaj urdhërese nga gjyqtari dhe se për gjykatën nuk është e njohur se ku është gjetur karikatorit, në cilën pjesë të shtëpisë, se ku është gjetur plumbi i pa shkrepur që përputhet me gëzhojen që gjendet në vendin e ngjarjes. Po ashtu nga shkresat e lëndës shihet se gjykata ka urdhëruar ekspertizën e daktiloskopisë për karikatorin e gjetur në shtëpinë e të akuzuarit për gjetjen eventuale të gjurmëve të vijave papilare mirëpo nga laboratorit i

SHPK- sektori i daktiloskopisë i datës 24.10.2007 nuk janë nxitur gjurmët e vijave papilare. Prandaj në një gjendje të tillë faktike dhe me provat e administruara gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur ka gjetur se nuk ka mundur ta vërtetojë se në veprimet e të akuzuarit qëndrojnë elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar pasi kjo u vërtetua edhe nga dëshmia e vajzës së të ndjerit por edhe anëtarëve tjerë të familjes që kanë dëshmuar se i akuzuari natën kritike ka qenë në shtëpi, se ka qenë fëmijë me trup mesatar të pa zhvilluar e që është e kundërta e asaj që ka deklaruar bashkëshortja e të ndjerit se personi i maskuar ka qenë korpulent dhe i zhvilluar e që nuk i përgjigjet ky përshkrim të akuzuarit, i ndjeri ka pasur letra kërcënuese edhe para luftës kur i akuzuari ka qenë fëmijë, motivet nuk kanë mundur të dëshmojnë me prova nga ana e prokurorisë prandaj në mungesë të provave drejtë është vendosur që i akuzuari të lirohet nga akuza.

Duke pasur parasysh se aktgjykimi i shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale si dhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë nuk kemi as shkelje të ligjit penal e që do ta kushtëzonte anulimin e aktgjykimit.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
PAKR.nr.35/18, më 01.03.2018

Procesmbajtësi,

Kryetarja e kolegjit – gjyqtarja,

Eroll Gashi \_\_\_\_\_

1. Mejreme Memaj \_\_\_\_\_

Anëtarët e kolegjit:

2. Driton Muharremi \_\_\_\_\_

3. Have Haliti \_\_\_\_\_